

Të dashur kolegë të EPALE,



Fokusi tematik i EPALE për muajin gusht ishte [të nxënit në vendin e punës](#). Ne promovam rolin e të nxënit në vendin e punës si një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e punonjësve dhe ruajtjen e efektivitetit të tyre. Ekipe kombëtare dhe komuniteti i EPALE kanë botuar një numër rastesh frymëzuese studimore, artikujsh, raportesh dhe burimesh të tjera mbi këtë temë. Ju mund t'i gjeni ato në faqen tonë të posaçme [Të nxënit në vendin e punës](#).

[Shihni një përmbledhje të fokusit të EPALE gjatë muajit gusht, të përgatitur nga Koordinatori Tematik Simon Broek] (në gjuhën angleze)

**Si pjesë e fokusit të EPALE gjatë muajit shtator tek aftësitë për shkrim- këndim dëshirojmë t'ju ftojmë të bëheni pjesë e diskutimit tonë me shkrim për të përcaktuar se cilat janë aftësitë për shkrim -këndim që nevojiten nga të rriturit dhe cilët janë faktorët e suksesit për një politikë efektive kombëtare në këtë fushë. Diskutimi do të jetë në gjuhën angleze dhe do të zhvillohet [në këtë faqe](#) nga data 4-7 shtator 2017. Ky diskutim do të moderohet nga Koordinatori Tematik i EPALE për Aftësitë për Jetën, [David Mallows](#), në bashkëpunim me partnerët tanë nga [Rrjeti European për Aftësitë Themelore \(EBSN\) \(linku është i jashtëm\)](#).**

### Postime në formë blogu

**[Organizimi i punës: Reflektime për një dimension shpesh të harruar të të nxënit në vendin e punës](#)** (në gjuhën angleze)

Çfarë është 'organizimi i punës' dhe si mund ta ndihmojë ai procesin e të nxënit në vendin e punës dhe zhvillimin e kompetencave? Ulrik Brandi nga Universiteti Aarhus dhe Rosa Lisa Iannone nga Universiteti i Luksemburgut bashkëndanë mendimet e tyre.

**[Një Udhërrëfyes European për Aftësitë Themelore që lidhen me Punën](#)** (në gjuhën gjermane, angleze, spanjolle, frënge, italiane dhe polake)

[Alex Stevenson](#), Shef i Gjuhës Angleze, Matematikës dhe *ESOL* (gjuha angleze për folësit e gjuhëve të tjera) në Institutin Kombëtar për të Nxënët dhe Punën në Angli dhe Uells, foli për çështjen e aftësive të ulëta themelore që pengojnë të nxënët në vendin e punës si dhe për projektin STRAIGHTEN për aftësitë themelore.

**[Të nxënët joformal në vendin e punës – a po marrin të rriturit një ofertë cilësore?](#)** (në gjuhën gjermane, angleze, spanjolle, frënge, italiane dhe polake)

Pjesa më e madhe e të nxënët në vendin e punës nuk është formale. Koordinatori Tematik i EPALE, [Andrew McCoshan](#), analizoi ato çfarë dimë dhe çfarë nuk dimë në lidhje me të si edhe problemet që dalin në pah kur flitet për cilësi.

**[Podcast-i i EPALE: Aftësitë e të rriturve për shkrim dhe këndim në vitin 2017?](#)** (në gjuhën angleze)

Në kuadrin e fokusit të EPALE gjatë muajit shtator tek shkrim-këndimi Koordinatorët tanë Tematikë [Andrew McCoshan](#), [Gina Ebner](#), [Markus Palmen](#) dhe [Simon Broek](#) u ulën së bashku për të diskutuar se çfarë nënkuptojmë me shkrim-këndim tek të rriturit, për rolin e tij tek Nisma e Rrugëve për Rritjen e Aftësive dhe për mënyrën sesi mund të përmirësohet mësimdhënia e aftësive për shkrim-këndim.

## Lajme nga mbarë Europa



Muaji gusht ka qenë një muaj i ngarkuar për sektorin e të rriturve në të gjithë Evropën:

- [Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ka publikuar raporte](#) për mënyrën sesi ndryshimet në teknologji dhe popullsia në plakje do të ndikojnë tek nevojat për aftësi në MB si edhe për mënyrën sesi

investimi tek aftësitë dhe promovimi i të nxënës gjatë gjithë jetës mund të ndikojnë tek produktiviteti (në gjuhën angleze).

- Ndërkohë në Slloveni [është shpallur një tender publik](#) për të përzgjedhur se cilat nga programet e formimit profesional do të botohen në Katalogun e Programeve të Arsimit dhe Formimit të Mëtejshëm 2017/18 (në gjuhën sllovene).
- Ministria Lituanëze e Arsimit dhe Shkencës [ka shpallur një konkurs](#) për arsimin joformal për të rriturit dhe për programet e vazhdueshme arsimore (në gjuhën lituanëze).

### **Bashkohuni tani!**

Mos harroni të regjistroheni në EPAL që të keni mundësi për të bashkëndarë opinionet tuaja mbi këto postime. [Bashkohuni tani](#) dhe bëhuni pjesë e komunitetit të përbërë nga 30 000 profesionistë të të Nxënës për të Rritur .